

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7824
E martë, 2 korrik 2024
Çmimi 0.50

Ndërron jetë
shkrimtari
Ismail Kadare | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEPARLAMENTARJA SLOVENE: MBËSHTESIM PERSPEKTIVËN INTEGRUESE TË KOSOVËS DHE ANËTARËSIMIN NË KIE | FAQE 3



Kryetarja e Kuvendit të Sllovenisë, Urska Klakocar-Zupancic, gjatë vizitës në Prishtinë, ka theksuar se

vendi i saj mbështet perspektivën integruese të Kosovës dhe anëtarësimin në KIE. Ndërkaq sa i përket

dialogut Kosovë - Serbi, ajo ka theksuar se dialogu është e vetmja rrugë përpara për të dyja vendet

KONJUFCA:
NË SERBI PO
PËRGATITEN
PËR SULM OSE
PROVOKIM
EVENTUAL
NË KOSOVË | F. 3



KALUESHMËRIA NË PROVIMIN E
MATURËS, 73.3 PËR QIND | F. 5



AKTUALE



SONDAZHI SHPËRFAQ
SHQETËSIME PËR SHËNDETIN
MENDOR TË BIDENIT | F. 2

ASK-ja, PAS DISA ANKESAVE,
FORMON KOMISION PËR PAGESAT
E REGJISTRUESVE | F. 6

385 RASTE TË PICKIMIT TË
NJERËZVE NGA RRIQRAT NË
MALISHEVË | F. 7

EKONOMI



FILLON SUBVENCIONIMI I POLICËS
KUFITARE PËR MËRGATËN,
GËRXHALIU: VENDIM POLITIK,
DIASPORA NUK MERITON TRAJTIM
VETËM NJË MUAJ | F. 8

GËRVALLA TAKON HOMOLOGUN
TURK, FLASIN PËR
BASHKËPUNIMIN EKONOMIK | F. 8

SPORT



PORTUGALIA DHE FRANCA
KUALIFIKOHEN NË ÇEREKFINALE | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bislimi dhe Petkoviqi në Bruksel për “zbatimin urgjent” të marrëveshjes

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviqi, do të takohen të martën në Bruksel në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Peter Stano, tha se prioritet në takim do të jetë “nisja urgjente e zbatimit të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve”. Për këtë marrëveshje Kosova dhe Serbia ranë dakord vitin e kaluar, por ajo nuk gjeti zbatim në terren. Takimin në mes të kryenegociatorëve e paralajmëruan javën e kaluar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, pas bisedimeve të ndara që zhvilluan me përfaqësuesin e lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell.

Kurti dhe Vuçiqi nuk u takuan bashkë, për shkak të, siç u tha, kushteve që nxori kryeministri i Kosovës, e që nuk i pranoi presidenti i Serbisë.

Kurti e kushtëzoi vazhdimin e

dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me tri kërkesa: nënshkrimin e Marrëveshjes për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve, tërheqjen e letrës me të cilën Serbia refuzoi zyrtarisht ta zbatonte marrëveshjen me Kosovën, dhe dorëzimin në Kosovë të Millan Radoičiqit, i dyshuar për sulmin e armatosur në Banjskë.

Stano u tha të hënën gazetarëve se qëllimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është “normalizimi i raporteve”. “Kjo detyrë është dhënë nga BE-ja si mandat për lehtësuesit e dialogut. Pra, mandati është t’u ndihmohet dy palëve që t’i normalizojnë raportet. Njohja [e Kosovës nga Serbia] nuk është pjesë e mandatit. Natyrisht, konsekuencë logjike e normalizimit do të ishte njohja. Por, kjo është diçka shumë larg në rrugën e procesit”, tha Stano.

Burimet diplomatike në Bruksel thonë se BE-ja po tenton që palët të bien dakord për një plan të sekuencuar të zbatimit të Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve.



Deri më tash palët kanë pasur qëndrime të ndryshme për këtë. Kosova nuk ka pranuar që prioritet kryesor të jetë themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbia ka refuzuar t’i zbatojë obligimet që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe me integritetin territorial të Kosovës. Për takimin e nesërm në mes të kryenegociatorëve foli të hënën edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Glauk Konjufca.


I pyetur nga gazetarët për qëllimin e këtyre bisedimeve, pas kushteve që i ka nxjerrë Kurti, ai tha se “çdo instancë duhet ta mbajë atë qëndrim” sa iu përket atyre kushteve. Ato kushte janë të arsyeshme, sipas tij, dhe “duhet të sqarohen, në mënyrë që dialogu të ketë sukses”.

Konjufca tha se nga BE-ja priten standardet më të larta, edhe të politikës, edhe të etikës në politikë.

Sipas tij, Borrelli dhe i dërguari i tij për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajcak, “nuk kanë vepruar sipas standardeve më të larta evropiane”. “Preferencat e tyre private dhe individuale kanë pasur ndikim të madh në mënyrën sesi e kanë formësuar dialogun”, tha Konjufca.

Më herët BE-ja i ka hedhur poshtë pretendimet e ngjashme të Kurtit se ndërmjetësuesit evropianë nuk janë neutralë.

Sondazhi shpërfaq shqetësime për shëndetin mendor të Bidenit



UASHINGTON, 1 KORRIK - Një sondazh i ri në Shtetet e Bashkuara sugjeron se disa votues demokratë janë gjithnjë e më të shqetësuar nëse Joe Biden është i aftë mendërisht për të shërbyer si president. Sondazhi nga mediumi “CBS News” dhe kompania e të dhënave, “YouGov”, u bë pas debatit në mes të Bidenit dhe kundërkandidatit republikan, Donald Trump, javën e kaluar. Ai tregon se 72 % e votuesve të regjistruar besojnë se Bideni nuk ka shëndet mendor për të shërbyer edhe një mandat. Shifra paraqet rritje në krahasim me 65 % të të anketuarve që thanë të njëjtën gjë në një sondazh të mëparshëm. Sondazhi i fundit tregon, po

ashtu, se 49 % e votuesve thanë se Trumpi nuk gëzon shëndet mendor për t’u rikthyer në Shtëpinë e Bardhë.

Shqetësime për moshën e kandidatëve - Biden është 81 vjeç dhe Trump është 78 - ka pasur edhe para debatit të 27 qershorit. Megjithatë, zëri i ngjirur dhe përgjigjet e ngatërruara të Bidenit i kanë rritur shqetësimet në mesin e demokratëve për kandidaturën e tij - disa prej të cilëve kanë bërë thirrje edhe për tërheqjen e tij. Vetë Biden ka pranuar se nuk ka pasur paraqitje të mirë gjatë debatit me Trumpin, por ka thënë se rizgjedhja e tij “do ta shkatërronte demokracinë”. Zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara do të mbahen më 5 nëntor.

Hungaria merr kryesimin e BE-së

BUDAPEST, 1 KORRIK - Hungaria, e udhëhequr nga kryeministri nacionalist i krahut të djathtë, Viktor Orban, ka marrë prej të hënës udhëheqjen me rotacion të Bashkimit Evropian.

Qeveria e saj ka paralajmëruar se do të përqendrohet në shtatë fusha - mes tyre: rritja e konkurrencës e BE-së, forcimi i politikës së mbrojtjes, zgjerimi dhe frenimi i

migracionit të paligjshëm. “Evropa përballë me sfida të përbashkëta nga lufta në fqinjësinë tonë, konkurrenca globale, situata e brishtë e sigurisë, migrimi i paligjshëm, fatkeqësitë natyrore, efektet e ndryshimeve klimatike dhe situata demografike”, ka thënë ministri hungarez për Çështjet Evropiane, Janos Boka, gjatë prezantimit të prioriteteve të presidencës hungareze të BE-

së muajin e kaluar. Në këtë detyrë Hungaria pason Belgjikën, e cila ka pasur kryesimin e BE-së në gjashtë muajt e parë të vitit. Nga 1 janari i vitit të ardhshëm ajo do t’ia kalojë këtë rol Polonisë. Pritjet janë që aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE, i bërë qysh në fund të vitit 2022, të mos shqyrtohet as gjatë presidencës hungareze.



Ndërron jetë shkrimtari Ismail Kadare



TIRANË, 1 KORRIK - Shkrimtari shqiptar, Ismail Kadare, vdiq të hënën në moshën 88-vjeçare. Kadare lindi në vitin 1936 në Gjirokastrë, një qytet i vogël në malet e jugut të Shqipërisë. Qyteti i tij, për të cilin shkroi romanin "Kronikë në gur", bën pjesë në trashëgiminë botërore që mbron UNESCO-ja. Tridhjetë vjet të karrierës së shkrimtarit, Kadare i jetoi në Shqipëri komuniste, ku edhe shkroi kryeveprat: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Prilli i thyer", "Dimri i madh" e "Ura me tri harqe". "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur", gazeta amerikane "Boston Globe" e përshkroi si "roman të fuqishëm dhe prekës". Ai, gjithashtu, hyri në 100 librat e shekullit të gazetës "Le Monde". Kadare është "një nga romancierët më bindës që shkruan në çdo gjuhë", shkroi "Wall Street Journal" për të. Librat e tij tashmë janë përkthyer në më shumë se 45 gjuhë të botës. Shumë prej tyre kanë qenë të ndaluara në Shqipëri komuniste - ndër to edhe "Pallati i ëndrrave", ku Kadare shtjellon marrëdhënien pushtet-individ. Në një intervistë për gazetën

"Financial Times" në vitin 2010, Kadare tha se është më së shumti krenar për këtë vepër. "Është shkruar në vitin 1980 dhe është botuar një vit më vonë, gjatë periudhës më të zezë të tiranisë shqiptare. Ishte një libër kundër asaj tiranie", tha Kadare. Për vitet e diktaturës shkroi edhe në veprat "Piramida" e "Koncerti". Kadare emigroi në Francë në vitin 1990, pasi bëri deklarata në favor të demokratizimit. Në vitin 1996 u bë anëtar i Akademisë Franceze të Shkencave Morale dhe Politike. Më 1998, kur edhe nisi lufta në Kosovë, Kadare publikoi librin "Tri ditë zie për Kosovën". Aty rrëfeu betejën e Kosovës më 1389, në të cilën disa mbretëri ballkanike i kanë bashkuar forcat kundër turqve dhe kanë humbur. Kadare fitoi disa çmime ndërkombëtare. Me vite u përmend edhe si pretendent i mundshëm për Çmimin Nobel për Letërsinë. Vitin e kaluar presidenti francez Emmanuel Macron i dha titullin "Oficeri i Madh i Legjionit të Nderit" gjatë një vizite që bëri në Tiranë.

Në dekadat e fundit, Kadare jetoi dhe shkroi midis Parisit e Tiranës. "Në Paris unë gjithmonë punoj në të njëjtën kafene. Në Tiranë kjo është e pamundur, për shkak të kuriozitetit të njerëzve", tha Kadare për "Financial Times".

"I gjithë populli shqiptar në zi"

Duke reaguar pas lajmit për vdekjen e Kadaresë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë tha se "ikja e tij është e pangushëllueshme" për të dhe për letërsinë shqipe. "Letërsisë shqipe do t'i mungojë kryemjeshtri, letërsisë evropiane do t'i mungojë fizikisht zëdhënësi i një kombi e një rajoni, qytetërimit tonë do t'i mungojë shqiptuesi i kumteve të mëdha", thuhet në reagim. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës iu referua atij si "emblemë e letërsisë bashkëkohore shqipe" dhe e përshkroi si "një nga shkrimtarët më të mëdhenj dhe më të njohur të letërsisë evropiane". Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, tha se "Shqipëria dhe shqiptarët humbën sot gjenin e

tyre të letrave, emancipuesin e tyre shpirtëror, Ballkani poetin e miteve të tij, Evropa dhe bota ndër përfaqësuesit më të spikatur të letërsisë moderne". "Të qoftë e lehtë lëndina në panteonin e përjetësisë, Kolosi ynë i mendimit dhe i penës!", shkroi Begaj në "Facebook". Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e cilësoi atë si "monumentin më të madh të kulturës shqiptare". Kadare e ngriti letërsinë dhe kulturën shqiptare "në majat e letërsisë, kulturës dhe qytetërimin botëror", tha edhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla. "Me veprën që krijoi, Ismail Kadare, shkrimtari shqiptar më i madh i të gjitha kohëve, u ngrit në Olimp e letrave shqipe", tha ajo. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se "populli i Kosovës, sikur i gjithë populli shqiptar, sot është në zi". "Ai humbi kolosin e dijetarin më të njohur shqiptar, humbi mbështetësin e pandalshëm të së drejtës së popullit shqiptar në Kosovë për të jetuar i lirë e i mosvarmë, e promovuesin e pandalshëm të kësaj të drejte

gjithandej botës", tha Osmani për Kadarenë, të cilit kohë më parë i dorëzoi edhe shtetësinë e Kosovës. "Anija e romaneve të Kadaresë do të lundrojë pafundësisht", tha në anën tjetër kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. "Ne humbëm shkrimtarin më të madh të të gjitha kohërave, bota humbi shkrimtarin e saj më të madh të gjallë", sipas tij. Për kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, "letërsia shqipe humbi një nga kolosët e saj më të veçantë, ndërsa kultura shqiptare mbeti pa ambasadorin e vet më të shquar". Pas vdekjes së Kadaresë reagoi edhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, duke e quajtur "gjigant të letërsisë". "Zëri i tij i fuqishëm letrar, i përkthyer në 45 gjuhë, ka bërë jehonë në të gjithë Evropën dhe më gjerë, duke i shfaqur botës kulturën e pasur dhe të larmishme shqiptare... Trashëgimia e Kadaresë do të mbetet", tha BE-ja. Në reagimin e Ambasadës Amerikane në Tiranë thuhet se vepra e Kadaresë "ka krijuar ura midis Shqipërisë dhe botës". (Rel)



Aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE do të mbetet në pritje

Kosova është i vetmi vend evropian i cili ka aplikuar për anëtarësim në BE, por nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim. Mbetet e vetmja nga dhjetë shtete të përfshira në procesin e zgjerimit të BE-së pa statusin formal të kandidatës. Pritjet që kërkesa e Kosovës për anëtarësim të merrej parasysh nuk janë realizuar

PRISHTINË, 1 KORRIK - Belgjika ka përfunduar kryesimin gjashtëmujor të Bashkimit Evropian dhe këtë detyrë, nga 1 korriku, për gjashtë muaj, e ka marrë Hungaria. Gjatë presidencës belge nuk ka ndodhur asnjë lëvizje për ta shqyrtuar aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE, që është bërë në dhjetor të vitit 2022, në fund të presidencës së atëhershme çeke. Kosova është i vetmi vend evropian i cili ka aplikuar për anëtarësim në BE, por nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim. Mbetet e vetmja nga dhjetë shtete të përfshira në procesin e zgjerimit të BE-së pa statusin formal të kandidatës. Pritjet që kërkesa e Kosovës për anëtarësim të merrej parasysh nuk janë realizuar. Presidenca suedeze e BE-së në pjesën e parë të vitit 2023 ka dështuar ta bëjë këtë. Pas saj, presidencën e ka pasur Spanja - vend që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe nuk ka dashur të ketë punë me dosjen e integritimit

evropian të Kosovës. Pas Spanjës, as Belgjika nuk ka bërë ndonjë hap në këtë drejtim. Arsye më të shpeshta që janë përmendur nga vendet që kanë pasur presidencën, për mosshqyrtimin e aplikimit të Kosovës, janë lidhur me "mungesën e konsensusit të vendeve anëtare". Sipas procedurave të BE-së për procesin e zgjerimit, Këshilli i BE-së duhet ta shqyrtojë aplikimin e një vendi për anëtarësim në BE dhe t'i japë mandat Komisionit Evropian për të analizuar nëse ai vend i përmbush apo jo kushtet për statusin e kandidatit. Pasi Komisioni ta përpilojë mendimin dhe ta japë rekomandimin, vendimin për dhënien e statusit e marrin njëzëshëm vendet anëtare. Kështu, me një shpejtësi të madhe, statusin e vendit kandidat e kanë marrë Ukraina dhe Moldavia, të cilat edhe i kanë nisur negociatat e anëtarësimit në BE muajin e kaluar. Statusin e vendit kandidat e

ka edhe Gjeorgjia dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor - Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina - me përjashtim të Kosovës. Formalisht, statusi kandidat ka edhe Turqia. Prej se Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE, diplomatët e vendeve anëtare thonë se do të bëjnë përpjekje për të arritur konsensus në Këshill, pasi pesë prej vendeve anëtare - Greqia, Sllovakia, Rumania, Spanja dhe Qiproja - nuk e njohin Kosovën shtet. Por, disa vende anëtare kanë sugjeruar se do të ishte mirë që, së paku, Këshilli t'i jepte mandat Komisionit Evropian për të analizuar se sa i përmbush Kosova kushtet për statusin e vendit kandidat. Komisioni Evropian ka shprehur gatishmërinë që ta kryejë pjesën e vet të punës, nëse një mandat të tillë e merr nga Këshilli. Por, nga ana e Këshillit nuk ka pasur ndonjë lëvizje. Kjo, përveçse me mosnjohjen nga pesë vendet anëtare, është arsyetuar edhe me pritjet se çfarë do të ndodhë me procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Përparimi në dialog është kusht edhe për Kosovën, edhe për Serbinë për progres në rrugëtimin e tyre drejt integritimit në BE. Kohën e fundit nuk ka pasur progres në këtë dialog dhe kjo ka ndikuar që

në mesin e vendeve anëtare të mos ketë entuziazëm për ta avancuar rrugën drejt BE-së as të Kosovës e as të Serbisë", ka thënë një diplomat evropian për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, sikur të kishte përparim në dialog vendet anëtare do të bindeshin më lehtë edhe për vendimin rreth Kosovës. Pas marrjes së presidencës së BE-së nga ana e Hungarisë, është paralajmëruar se ky vend do ta ketë prioritet edhe procesin e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Hungaria e ka vënë këtë edhe në dokumentin ku përmendën prioritetet e udhëheqjes së saj me BE-në. Budapesti ka aspiratë që ta avancojë procesin e negociatave me ato vende candidate që do të jenë të gatshme. Diplomtatë nga Hungaria citohen të kenë thënë se synojnë mbylljen e disa kapitujve të negociatave të anëtarësimit me Malin e Zi, si dhe hapjen e disa kapitujve me Serbinë, me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut. Po ashtu, ata kanë përmendur edhe mundësinë e avancimit të Bosnjë-Hercegovinës. Por, diplomatët kanë vërejtur se Hungaria nëpër takime nuk ka përmendur ndonjë veprim të mundshëm rreth Kosovës. Diplomtatë evropianë nënvizojnë se Qeveria e Hungarisë ka raporte të afërta me Serbinë dhe kjo ka ndikuar që sjellja e saj rreth Kosovës në BE dhe në disa

organizata të tjera ndërkombëtare të mos jetë aq miqësore sa ka qenë më herët. Megjithatë, Hungaria i ka vazhduar kontaktet me Kosovën. I pyetur për pritjet nga presidenca hungareze e BE-së, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë javën e kaluar në Bruksel se "Hungaria e ka njohur Kosovën dhe duhet t'i jepet rasti për të parë në muajt e parë të presidencës se si do të veprojë". Hungaria, në anën tjetër, ka shprehur pritjet që gjatë kryesimit të saj me BE-në, të bëhen pagesat e para për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor nga paketa prej 6 miliardë eurosh e planit evropian për rritje ekonomike dhe reforma në rajon. Mjetet nga kjo paketë për Kosovën dhe Serbinë janë të kushtëzuara, po ashtu, me angazhimin konstruktiv të tyre në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Hungaria planifikon që gjatë kryesimit të saj me BE-në, të organizojë edhe një samit të përbashkët të BE-së me udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndonëse Hungaria ka raporte më të afërta me Serbinë në mesin e vendeve të rajonit, diplomatët në Bruksel nuk presin që të ketë probleme në raportet me vendet e tjera, pasi roli i vendit kryesues të BE-së është që të jetë një udhëheqës neutral i Këshillit të Bashkimit Evropian dhe t'i lërë anash prioritetet e veta nacionale gjatë periudhës gjashtëmujore.

Konjufca: Në Serbi po përgatiten për sulm ose provokim eventual në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të hënën se institucionet e vendit kanë "informacione të sakta" se "një grup prej qindra personash" në Serbi janë duke u përgatitur për një sulm eventual në Kosovë.

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se institucionet e vendit kanë "informacione të sakta" se "një grup prej qindra personash" në Serbi janë duke u përgatitur për një sulm eventual në Kosovë. "Institucionet tona të sigurisë janë në vigjilencën më të

lartë për t'u përballur me çfarëdo që vjen - ose sulm, ose provokim - nga ana e Serbisë", tha ai. Duke mos ofruar më shumë detaje, ai tha se institucionet e Kosovës "janë në koordinim të plotë edhe me institucionet ndërkombëtare të sigurisë që veprojnë në Kosovë".

Konjufca i bëri komentet në një konferencë për gazetarë në Prishtinë, ku mori pjesë edhe kryetarja e Kuvendit të Sllovenisë, Urska Klakocar Zupančič. Ngjashëm u shpreh edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, javën e kaluar, kur tha se Millan Radoičiq, i cili e mori përgjegjësinë për një sulm të armatosur në veri të Kosovës, shtatorin e kaluar, "vazhdon trajnimet në Serbi" për sulme të reja në Kosovë. Radoičiq - ish-nënkryetar i Listës

Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - besohet se është i lirë në Serbi. Në sulmin e 24 shtatorit në Banjskë, kundër policisë së Kosovës, mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku. Në përleshjen e armatosur që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë. Ngjarja nxitu shqetësimet për sigurinë rajonale dhe thirrje nga bashkësia ndërkombëtare që autorët të sillen para drejtësisë. Ndihmësekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, tha në fundjavë se Serbia ka premtuar

se Radoičiqi do të përballet me ligjin lidhur me ngjarjet e shtatorit të kaluar. Si ShBA-ja ashtu edhe Bashkimi Evropian vazhdimisht u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të kthehen në tryezën e bisedimeve. Javën e kaluar Kurti ishte në Bruksel për një raund të ri bisedimesh me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, por takimi nuk u realizua për shkak të disa kushteve që nxori Kurti e që Vuçiqi nuk i pranoi, në mesin e tyre edhe dorëzimi i Radoičiqit.



Kalueshmëria në Provimin e Maturës, 73.3 për qind

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka publikuar rezultatet e Provimit Shtetëror të Maturës, të cilit i janë nënshtruar 18 285 mijë nxënës të klasave të dymbëdhjeta në gjithë vendin. Këtë vit Provimin e Maturës e kanë kaluar 13.342 nxënës apo 73.3 % e maturantëve. Arritshmëria mesatare në Gjuhë Amtare është 58.8 %, në Gjuhë Angleze 54.4 % në Matematikë 41.1 % dhe në Lëndën Zgjedhore 47.3 %. Rezultatet e Provimit Shtetëror të Maturës tashmë janë shpërndarë në shkolla. Provimi i mbajtur më 22 qershor është organizuar në 151 qendra të testimit. Në këtë proces kanë qenë të angazhuar 180 kryetarë

të komisioneve të caktuar nga MASHTI, 1 500 administrues dhe 1 500 mbikëqyrës nga Parlamenti i Studentëve të UP-së. Gjatë procesit të administrimit ka pasur tentime për kopjim nga disa nxënës dhe si pasojë e posedimit dhe përdorimit të telefonit janë përjashtuar 79 nxënës. Afati i ankesave është deri më 05.07.2024, kurse rezultati i ankesave publikohet më 08.07.2024. Të gjithë kandidatët që nuk kanë arritur kriterin prej 40 % mund të hyjnë në afatin e gushtit i cili organizohet më 31.08.2024. MASHTI i ka falënderuar të gjithë të përfshirët në procesin e mbajtjes së Provimit Shtetëror të Maturës për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre.



ASK-ja formon komision për pagesat e regjistruessve, pas disa ankesave

PRISHTINË, 1 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës ka njoftuar të gjithë regjistruessit e angazhuar në procesin e regjistrimit të popullsisë se ka formuar një komision që do të merret me shqyrtimin e të gjitha ankesave rreth pagesave për periudhën e angazhimit për punën në terren. ASK-ja thekson në një njoftim

se me pranimin e disa ankesave rreth mënyrës së pagesave, komisioni në fjalë do të merret me verifikimin në sistem të secilit regjistruess dhe pyetësorëve të aprovuar nga sistemi, në mënyrë që të vërtetohet ndonjë lëshim teknik që ka mund të ndodhë. "Në bazë të ankesave të pranuar deri më tani, shihet

se ka një keqkuptim nga regjistruessit rreth mënyrës së kompensimit ndërmjet pagës bruto dhe neto, mënyrës së përlogaritjes së pyetësorëve të plotësuar, si dhe në disa raste për ato intervista që sistemi i ka klasifikuar si intervista jo të rregullta. Sidoqoftë, ASK-ja do të veprojë sipas të gjitha procedurave dhe në bazë

kontratës. Nëse verifikohet ndonjë lëshim teknik eventual, kompensimi i mjeteve do të kryhet menjëherë. Të gjitha ankesat mund të parashtrihen te Departamenti i Administratës së ASK-së në email: infoask@rks-gov.net. Edhe një herë, ASK-ja falënderon të gjithë Mbikëqyrësit dhe



Regjistruessit për punën e shkëlqyer dhe angazhimin e tyre maksimal në procesin e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)", thuhet në njoftimin për medie.

Rektori i UP-së merr pjesë në konferencën rajonale të rektorëve të Evropës Qendrore dhe Lindore

PRISHTINË, 1 KORRIK - Rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, ka marrë pjesë në konferencën rajonale të rektorëve të Evropës Qendrore dhe Lindore të mbajtur në Bukuresht të Rumanisë.

Konferenca është organizuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF). Pjesëmarrës në këtë konferencë kanë qenë përfaqësuesit e universiteteve anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore.

Në konferencë është diskutuar për një sërë temash të interesit të përbashkët për institucionet e arsimit të lartë në këtë rajon, përfshirë në mënyrë të veçantë ndërkombëtarizimin, inteligjencën artificiale dhe sigurinë kibernetike, si dhe kërkimin dhe zhvillimin. Në mënyrë të veçantë janë shqyrtuar



mundësitë e rritjes së shkëmbimeve dhe publikimeve akademike, përfshirë me mbështetjen e AUF-it, të universiteteve partnere dhe institucioneve të tjera.

Në këtë konferencë rektori i UP-së, prof. Qerimi, ka mbajtur një fjalim për temën e ndërkombëtarizimit të institucioneve të arsimit të lartë në Evropën Qendrore dhe Lindore. Në fjalën e tij, rektori Qerimi ka thënë se "ndërkombëtarizimi është i domosdoshëm për vetë ekzistencën tonë institucionale dhe është thelbësor për studentët, stafin dhe universitetet si tërësi, duke pasur efekte të pashembullta në shoqëritë tona individuale dhe në rajonin më të gjerë".

Ai ka shprehur bindjen se e ardhmja më e mirë qëndron në zotimin për ta zgjeruar angazhimin dhe

ndikimin ndërkombëtar përmes veprimeve strategjike që synojnë nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor. "Si përfundim, besoj fuqishëm se ndërkombëtarizimi nuk është vetëm një imperativ strategjik, por një detyrim moral për institucionet e arsimit të lartë në botën e sotme.

Ndërkombëtarizimi na ndihmon t'i thyejmë barrierat, ta nxisim mirëkuptimin e ndërsjellë dhe ta kultivojmë brezin e ardhshëm të qytetarëve dhe udhëheqësve globalë. Ndërsa vazhdojmë në këtë rrugëtim ndërkombëtarizimi, le të shfrytëzojmë mundësitë para nesh, që të përqafojmë dhe zgjerojmë diversitetin dhe të përpiqemi për përsosmëri në të gjitha ndërmarrjet tona", ka deklaruar rektori Qerimi.

Mbi 125 milionë euro pritet të jetë buxheti trevjeçar i Gjilanit

GJILAN, 1 KORRIK - Ka përfunduar cikli i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 në komunën e Gjilanit.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Herolinda Murati-Leka, tha se dëgjimet buxhetore të organizuara me qytetarët e komunës kanë përfunduar me sukses dhe, në këtë mënyrë, tani kalohet në fazën tjetër të buxhetimit komunal. Sipas saj, propozimet e dala nga këto dëgjime buxhetore do të shqyrtohen në mënyrë që të bëhen pjesë integrale e buxhetit të komunës sonë për tri vitet e ardhshme. "Duhet theksuar se

buxheti për të cilin është diskutuar përfshin në kumulativ trevjeçar një shumë prej 125,802,647.00 eurosh", tha Herolinda Murati-Leka.

Drejtoresha për Buxhet e Financa më tej shtoi se me këto dëgjime buxhetore, qytetarëve të komunës sonë u është dhënë mundësia që të marrin rol aktiv në procesin e planifikimit të buxhetit të gjithë bashkëqytetarët, të cilët kanë gjetur kohë që t'i përgjigjen pozitivisht thirrjes për këto dëgjime buxhetore. Sipas saj, pjesëmarrja e tyre ka qenë e një reprezentacioni jashtëzakonisht heterogjen.



Drejtoresha për Buxhet e Financa shtoi se në këto takime kanë pasur banorë të lagjeve urbane, banorë të fshatrave që nga fshatrat e afërta e deri tek ato kufitare, ka pasur gjithashtu përfaqësues të organizatave rinore, OJQ, studentë, sportistë, përfaqësues nga komuniteti i kulturës, gra pensioniste, gra të vetëpunësuar, aktiviste e grupe të tjera të interesit. "Ky interesim për të qenë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore shpërfaq më së miri besimin që qytetarët kanë në këtë proces të rëndësishëm të planifikimit të buxhetit për komunën tonë", tha drejtoresha Murati-Leka.

Kryeprokurori Zejnullah takon ambasadorin italian, bisedojnë për sistemin prokurorial

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryeprokurori Zejnullah Gashi brenda ambienteve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka prituar ambasadorin italian Antonello De Riu dhe këshilltarin e tij Nikollë Perlaska. Fillimisht, kryeprokurori Gashi u shprehu mirëseardhje të pranishmëve dhe i njoftoi me funksionimin dhe aktivitetet të cilat i realizon Prokuroria Themelore në Prishtinë, si prokurori themelore më e

madhe në nivel të Kosovës. Ndër të tjera, theksoi rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies, si një ndër prioritetet e kësaj prokurorie, për të vazhduar më pas me prioritetet e tjera si: trajtimin e rasteve të dhunës në familje, luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit, veprat penale kundër integritetit seksual, të miturit në konflikt me ligjin etj. Në këtë takim u diskutua për

rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me shtetin italian për sistemin prokurorial, ku kryeprokurori Gashi dhe ambasadori De Riu theksuan mundësinë e trajnimeve me prokurorë italianë me fokus në krime ekonomike, duke e parë këtë si një mundësi unike për të ndarë perspektiva të ndryshme nga të cilat do të përfitonte sistemi ligjor i Kosovës.



Kryeparlamentarja sllovene: Mbështesim perspektivën integruese të Kosovës dhe anëtarësimin në KiE



Kryetarja e Kuvendit të Sllovenisë, Urska Klakocar-Zupancic, gjatë vizitës në Prishtinë, ka theksuar se vendi i saj mbështet perspektivën integruese të Kosovës dhe anëtarësimin në KiE. Ndërkaq sa i përket dialogut Kosovë - Serbi, ajo ka theksuar se dialogu është e vetmja rrugë përpara për të dyja vendet

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryetarja e Kuvendit të Sllovenisë, Urska Klakocar-Zupancic, pas takimit që zhvilloi me kryeparlamentarin Glauk Konjufca, ka thënë të hënën në Prishtinë se raportet e dy kuvendeve janë shumë të qëndrueshme dhe miqësore. Ajo në një konferencë për medie, tha se vizita e saj kontribuon në thellimin e raporteve mes dy vendeve. "Bashkë me Konjufcën kemi pasur një takim të këndshëm dhe miqësor. Raportet e Kuvendit janë të qëndrueshme dhe shumë miqësore. Duam që ta shohim këtë bashkëpunim që të zhvillohet më tutje nga të

gjitha fushat. Gjithmonë ka shumë mundësi për të forcuar dhe zhvilluar këtë raport. Kjo vizitë kontribuon në thellimin e raporteve mes dy kuvendeve. Kuvendi është i gatshëm që të ndaj eksperiencat e mira sa i përket eksperiencës që Sllovenia ka me BE-në dhe me përmbushjen e kriterëve për anëtarësim. Kosova dëshiron që të bëhet anëtare e BE-së dhe Sllovenia mund ta ndihmojë Kosovën këtu shumë. Ne mbështesim perspektivën integruese të Kosovës dhe anëtarësimin në KiE", tha ajo. Më tutje Zupancic u shpreh se Sllovenia e mbështet përpjekjen e Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Ajo foli edhe për dialogun Kosovë - Serbi:

"Dialogu është e vetmja rrugë përpara dhe gjithmonë na tregon që është rruga e duhur, si dhe dy vendet janë të përkushtuara për dialog, prandaj dhe ne jemi prezent këtu si pjesë e KFOR-it", tha ajo. Po ashtu, kryeparlamentarja sllovene theksoi se: "Besojmë që kjo vizitë nuk është e fundit dhe ne do t'i hapim dyert për një bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe do t'ju mbështesim në rrugën e BE-së dhe përpjekjet e juaja për anëtarësim në institucionet e rëndësishme".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se Sllovenia mbetet një shtet mik për Kosovën. "I nderuar që ta pres në vizitën e saj të parë në Kosovë, kryetaren e Asamblesë së Sllovenisë, zonjën Zupancic. Kryetares i urova mirëseardhje dhe e falënderova për mbështetjen e palëkundur që Sllovenia i jep Kosovë në shumë procese sidomos ato eurointegruese", tha Konjufca. Ai shtoi se homologen sllovene e ka njoftuar edhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror në Kosovë, si dhe e ka falënderuar edhe për procesin e liberalizimit të vizave

dhe çështjes së anëtarësimin të Kosovën në Këshill të Evropës. "E falënderova për përkrahjen e procesit të liberalizimit të vizave, proces ky i stërzgatur dhe padrejtësisht i vonuar për qytetarët tanë. E falënderova edhe për mbështetjen për anëtarësim në Këshillin e Evropës", tha ai.

Kryeparlamentari shtoi se me Zupancic kanë diskutuar edhe për sfidat aktuale dhe në Ballkan. Konjufca theksoi se homologes i ka shprehur shqetësimin për tendencën destabilizuese të Serbisë. "Ja shpreha shqetësimin tonë si popull dhe si shtet për tendencën destabilizuese të Serbisë në Kosovë, ku kulmuan me sulmin ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në Banjskë vitin e kaluar. Nuk mund të flasim për fqinjësi të mirë dhe paqe në rajon pa u dënuar dhe pa i vënë para drejtësisë kryerësit e këtij krimi dhe pa u adresuar përpjekjet e tilla destabilizuese", tha Konjufca.

Klakocar-Zupancic është takuar edhe me presidenten Vjosa Osmani dhe zëvendëskryeminstren dhe ministren e Jashtme, Donika Gërvalla.

Kryeparlamentarja sllovene në Aeroportin "Adem Jashari" u prit nga nënkryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Saranda Bogujevci.

Duke i uruar kryeparlamentares sllovene mirëseardhje në Republikën e Kosovës, nënkryetarja Bogujevci çmoi lart marrëdhëniet e deritashme midis Kosovës dhe Sllovenisë, përkatësisht midis parlamenteve, si dhe avancimin e tyre gjatë viteve.

Bogujevci e konsideroi të vyer për Kosovën dhe Kuvendin e saj rrugën e zhvillimit të demokracisë e të integritit euroatlantik të shtetit slloven. Ajo falënderoi kryetaren Klakocar Zupancic për ndihmën e madhe e të pakursyer të vendit të saj për Kosovën në kohë dhe rrethana të ndryshme, ndërsa shtroi nevojën që kjo mbështetje të vazhdojë edhe në të ardhmen për arritjen e synimeve të saj zhvillimore dhe eurointegruese.

Kryetarja e Kuvendit të Sllovenisë theksoi përkushtimin e Sllovenisë për thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve, në frymën e bashkëpunimit e të miqësisë.

385 raste të pickimit të njerëzve nga rriqrat në Malishevë

MALISHEVË, 1 KORRIK - Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara në Malishevë, në mbledhjen e tretë të rregullt të Komitetit, të mbajtur të hënën, të kryesuar nga Aziz Thaçi, shqyrtoi dhe debatoi për raportin pesëmuor të dërguar nga QKMF-ja. Sipas raportit, brenda kësaj periudhe në territorin e komunës së Malishevës janë pickuar 385 persona, por asnjë nuk është i

hospitalizuar. "Një menaxhim i mirë u përkushtohet punës dhe ekipeve mjekësore të cilët mbajtën ligjërata të drejtpërdrejta me nxënës të shkollave dhe kjo padyshim ka ndikuar në informimin e tyre. Po ashtu angazhim në këtë drejtim kanë dhënë edhe sektorët e bujqësisë dhe të emergjencave të cilët dolën në terrene fushore, ku bënë spërkatjen e hapësirave publike. Këta janë faktorë që mbrojtën banorët që punojnë

në fusha nga pickimet e rriqrave. Këshilla profesionale nga anëtarët e komitetit është se situata me ethet hemorragjike nga rriqrat nuk është tejkaluar tërësisht, prandaj edhe kërkohet përkujdesje nga të gjithë qytetarët që t'u përmbahen rregullave të mbrojtjes nga rriqrat, sidomos në këta muajt e vapës dhe punës në fusha", ka njoftuar komuna e Malishevës.



Gërvalla takon homologun turk, flasin për bashkëpunimin ekonomik

PRISHTINË, 1 KORRIK - Fuqizimi i bashkëpunimit ekonomik, mbështetja në anëtarësimin në organizata ndërkom-bëtare, iniciativat e përbashkëta rajonale, bashkëpunimi në siguri dhe mbrojtje, ishin temat në fokus të takimit që zëvendëskryeministria dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika

Gërvalla, pati me ministrin e Jashtëm të Turqisë, Hakan Fidan, të mbajtur në marginat e Forumit të Dubrovnikut. Ministria Gërvalla dhe ministri Fidan vlerësuan bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve tona, përfshirë përkrahjen unanime nga deputetët e Turqisë në Asambleenë Parlamentare të

Këshillit të Evropës lidhur me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.

Një vlerësim i veçantë u shpreh për angazhimin e Turqisë në kuadër të NATO-s dhe KFOR-it, duke e cilësuar si përkrahje të drejtpërdrejtë për paqen dhe sigurinë në rajon. Ministria Gërvalla veçanërisht

mirëpriti rolin konstruktiv të komandantit turk të KFOR-it në Kosovë.

Në kontekst të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe aspiratës legjitime të Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO, ministria Gërvalla mirëpriti vazhdimin e përkrahjes turke për



realizimin sa më të shpejtë të këtij synimi.

Fillon subvencionimi i policës kufitare për mërgatën, Gërxhaliu: Vendim politik, diaspora nuk meriton trajtim vetëm për një muaj

EPOKA

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Me vendim të Qeverisë së Kosovës ka filluar subvencionimi i policës kufitare për mërgatën. Duke filluar nga 1 korriku, të gjithë bashkatdhetarët që udhëtojnë për në Kosovë me automjete për pasagjerë do të mund ta marrin policën e sigurimit falas në cilëndo prej pikave kufitare hyrëse.

Polica e subvencionuar do të ketë vlefshmëri 1 muaj nga dita e lëshimit/hyrjes në Kosovë dhe subvencionohet vetëm për automjetet jokomerciale për pasagjerë deri në 9 ulëse. Në lidhje me këtë vendim ka

folur ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë për "Epokën e re" se çfarëdo që Kosova të bëjë për diasporën nuk mund ta falënderojë atë për kontributin e dhënë në shumë procese në Kosovë në të kaluarën, tani dhe në të ardhmen.

Në këtë drejtim ai ka thënë se nuk duhet të kemi një qasje selektive, por thotë se duhet të kemi qasje gjithëpërfshirëse. "Në qoftë se BQK-ja ka këtë komoditet dhe këtë guxim për ta ulur koston dhe për të paguar koston për diasporë, atëherë duhet ta kemi parasysh edhe faktin tjetër: diçka të tillë e meritojnë edhe qytetarët e



Kosovës, në veçanti duke pasur parasysh shkallën e inflacionit dhe krizën sociale që po kaplon Kosovën. Në qoftë se brenda një viti ose për dy muaj korrik dhe gusht kemi afër 200 mijë

vetura dhe totali koston është 4 milionë euro, këtu duhet të kemi konsideratë edhe për qytetarët e tjerë të Kosovës, pra duhet të kemi qasje motivuese dhe gjithëpërfshirëse. Tani është koha kur duhet reflektim", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka theksuar se diaspora nuk meriton trajtim vetëm për një muaj apo dy. "Diaspora meriton trajtim gjatë gjithë vitit. Me këtë qasje që është shumë më tepër politike sesa ekonomike dhe sociale. Duhet të inkorporohet edhe faktori qytetar i Kosovës dhe jo që këto lirime të jenë vetëm për diasporën. Më 31 janar 2024 ka ndodhur zbritja 35 për qind. Kjo dëshmon se një ulje të tillë

e kemi pasur edhe në vitin 2019 me 26,5 për qind. Pra në një masë të tillë, nëse kemi guximin dhe forcën ekonomike që të veprimë për diasporën, atëherë të veprimë edhe për qytetarët e Kosovës. Lindin pyetjet: A mund të ketë orientime të investimeve diku tjetër? Pse nuk është prioritet i prioritetëve anëtarësimi dhe lobimi për kartonin e gjelbër? Prandaj besoj se kjo procedurë të depolitizohet dhe duhet që diaspora ta ketë një trajtim pak më ndryshe, e ky problem të zgjidhet në aspektin horizontal dhe jo që në aspektin vertikal të jetë i targetuar vetëm një grup në një periudhë të caktuar kohore", ka thënë Gërxhaliu.

'EC Ma Ndryshe': Komuna e Prizrenit ende e pafuqishme për vendosjen e rregullit urbanistik

PRIZREN, 1 KORRIK - OJQ 'EC Ma Ndryshe' ka theksuar se komuna e Prizrenit po tregohet e pafuqishme sa i përket vendosjes së rregullit urbanistik në ndërtimet e ndryshme, si në Qendrën Historike të Prizrenit ashtu edhe në zonat e tjera të qytetit. Sipas kësaj OJQ-je, në pesë muajt e parë të këtij viti janë identifikuar së paku pesë raste të ndërtimeve me tejkalime të pëlqimeve të lëshuara nga autoritetet e trashëgimisë kulturore apo të lejeve ndërtimore të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor. "Në mesin e këtyre

rasteve nga organet përkatëse është konstatuar mbindërtimi i një kati pa lejen e DUPH-së në objektin kolektiv banesor në rrugën 'Xhemil Fluku', pastaj ndërtimi i një aneksi pa leje ndërtimore në ndërtesën e banimit kolektiv në rrugën 'Adnan Krasniqi' dhe, po ashtu, në një ndërtim të objektit individual në rrugën 'Rifat Krasniqi', ku te ndërtimi i nënkulmit është evidentuar tejkalimi i lejes së lëshuar nga DUPH-ja. Gjithashtu, janë identifikuar punime në një ngastër kadastrale në rrugën 'Brigada Proletare' në zonën e Nënkalasë në Qendrën Historike



të Prizrenit ndonëse ka pretendime se ka skadim të aktit administrativ për këtë lëndë. Ndërkohë edhe në një rast në rrugën 'Bujtinat' është vërejtur mosrespektimi i vendimit të lëshuar nga autoritetet e trashëgimisë kulturore, ku përkundër rekomandimeve të dhëna të gjitha hapësirat janë

shfrytëzuar për ndërtim dhe ka tejkalim të lartësisë së përdhësës", ka theksuar 'EC Ma Ndryshe'. EC përkujton se gjatë dy dekadave të fundit Prizreni është përballur me parregullsi urbanistike, që ka pasur efekt negativ edhe në zonën historike. "Praktikat e tilla kanë ndikuar në degradimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, gjë e cila ndikon negativisht në përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm lokal. Këto praktika kanë pasoja edhe në mjedisin dhe infrastrukturën urbanistike ku në fund pësojnë qytetarët. Prandaj, 'EC' konsideron se ka ardhur koha që institucionet të veprimë me forcën e ligjit për ta

vendosur rendin urbanistik. Për këtë arsye rekomandon organet komunale dhe institucionet e tjera që kanë kompetencë në këtë fushë që ta shtojnë praninë në terren, për të vepruar në mënyrë urgjente dhe konkrete për parandalimin e rasteve të tilla, në mënyrë që mos të krijohen precedentë edhe për raste të tjera të ngjashme. Gjithashtu, u bënë thirrje të gjitha palëve të veprimë sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe punimet ndërtimore të realizohen vetëm konform lejeve ndërtimore të marra nga organet përkatëse", është bërë me dije në komunikatën e 'EC Ma Ndryshe'.

Përfaqësueset e ZKA-së ndoqën trajnimin "Luftimi i marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike" në Budapest

PRISHTINË, 1 KORRIK - Në datat 24-28 qershor 2024 në Budapest të Hungarisë u mbajt kursit njëjavor "Luftimi i marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike" i organizuar nga Akademia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit - ILEA Budapest, pjesë e të cilit ishin Republika Çeke, Jordania dhe Kosova. Në këtë aktivitet Zyra Kombëtare e

Auditimit të Kosovës u përfaqësua nga drejtoresha e Departamentit të Auditimit, Fatlinda Ramosaj dhe zyrtarja e lartë për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve, Natyra Kasumaj, të cilat janë certifikuar pas përfundimit të seancave trajnuese dhe ushtrimeve praktike.

Programi i kursit njëjavor pati për qëllim pajisjen e

pjesëmarrësve me strategji dhe mjete për ta identifikuar sjelljen e fshehtë dhe për të zbuluar dhe penguar në mënyrë efektive manipulimin e ofertave në prokurimet publike. Ushtrimet praktike dhe udhëzimet janë përshtatur bazuar në përvojën e gjerë të Departamentit të Drejtësisë në bashkëpunimin me



agjencitë e prokurimit në mbarë botën. Ky aktivitet është mbështetur nga Byroja për Çështje

Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL) e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Jacques Attali: Pa koalicion, Olimpiada do jetë si Berlini 1936



La cohabitation, c'est moi. Jacques Attali ishte në Elysee nën hijen e François Mitterrand kur presidenti socialist e gjeti veten përballë Jacques Chirac, i cili ishte bërë kryeministër me një shumicë të krahut të djathtë. Kështu lindi bashkëjetesa. "Kjo nuk kishte ndodhur kurrë në Republikën e Pestë, e gjetëm veten duke shpikur një praktikë republikane", kujton Attali, këshilltari i Mitterrand për dhjetë vjet dhe më pas mentori i Emmanuel Macron.

Ekonomist, intelektual, drejtues orkestre, eseist popullor, Attali tani po i drejton një apel Presidentit për të bërë pakt me të majtën në funksion të raundit të dytë. "Unë votova për Frontin e Ri Popullor, pa hezitim. Për mua prioritet është të parandaloj të djathtën ekstreme që të vijë në qeveri në Francë", tregon Attali, 80-vjeçar, i cili nuk e fsheh pesimizmin e tij nga një duel hipotetik në krye të shtetit, mes Macron dhe Jordan Bardella.

Çfarë këshille do t'i jepnit Macron-it për t'u marrë me krizën e afërt?

Nuk jam i sigurt se i dëgjon këshillat e mia. Unë isha kundër idesë së shpërbërjes së Assemblée Nationale, veçanërisht vetëm disa javë para Lojërave Olimpikë, në të cilat e gjithë bota do t'i ketë sytë nga Franca. Ne synonim një festë si Lojërat e Parisit të vitit 1924, tani rrezikojmë të kemi Lojërat e Berlinit të vitit 1936. Dëmi tashmë

është bërë, le të shpresojmë që të mos jetë i riparueshëm. Thënë kjo, do të shohim nëse Macron ka mjaftueshëm gjakftohtësi për t'u imponuar si Mitterrand. Por në rastin e tij tashmë ka një ndryshim.

Cili është?

Të gjithë e dinë se ai nuk do të mund të kandidojë sërish për zgjedhjet e ardhshme presidenciale, për shkak të kufizimeve kushtetuese. Pësha politike e Macron në Elysee është natyrshëm më e vogël. Mitterrand kishte kandiduar sërish pas bashkëjetesës së parë dhe gjatë bashkëjetesës së dytë (me Edouard Balladur). Ai tashmë ishte shumë i sëmurë dhe në qeveri ishte krijuar një formë respekti. Sot ka një dobësi objektive të Macron që kundërshtarët e tij do ta theksojnë fort. Si Marine Le Pen ashtu edhe Jean-Luc Mélenchon kanë interes për zgjedhjet presidenciale para vitit 2027. E njëjta gjë ndodhi në fillimet e bashkëjetesës së parë mes Mitterrand dhe Chirac. Kryeministri ishte i bindur se do të ishte në gjendje të detyronte presidentin të jepte dorëheqjen. Dhe në vend të kësaj presidenti bëri edhe një mandat të dytë. Tani gjithçka është ndryshe. Macron nuk do të jetë në gjendje të kandidojë për një mandat të tretë. Ai do të ketë humbur shumicën e deputetëve dhe në shtatë vjet nuk ka dashur kurrë të ndërtojë një parti të vërtetë. Kështu që presioni ndaj Macron për t'u larguar do të

rritet. Natyrisht nuk e shpresoj. Në të vërtetë, mendoj se është shumë e rëndësishme që ai të mos largohet: duhet të mbrojtë institucionet, të cilat janë thesari i vërtetë i Republikës sonë.

Si arriti të imponohej Mitterrand përballë një mazhorance armiqësore?

Ishte një betejë e vazhdueshme. Mbjaj mend një mbledhje të parë ku arriti të sigurohesha që të mos kishte asnjë goditje diplomatike nga kryeministri, për të afirmuar epërsinë e Presidentit ndaj politikës së jashtme. Një herë tjetër Mitterrand refuzoi të firmoste një dekret. Chirac ishte aq i zemëruar sa e kërcënoi se do ta dëbonte fizikisht nga Elysee. Presidenti nuk e besoi, por dyshonte dhe më kërkoi të qëndroja me të në pallatin presidencial. Mitterrand kundërshtoi edhe mbledhjen e një Këshilli të Mbrojtjes, në të cilin kryeministri donte t'i jepte ushtrisë, armë bërthamore taktike. Bashkëjetesa është një ekuilibër i paqëndrueshëm, ku strategjia, temperamentit dhe karizma kanë rëndësi. Marine Le Pen tashmë ka filluar të vërë në dyshim prerogativat e presidentit për mbrojtjen dhe BE-në. "Me Mitterrand-in, në dy bashkëjetesat e para, krijuam një lloj jurisprudence mbi të ashtuquajturën "domaine réservé", një kompetencë ekskluzive e

Elysee. Edhe në bashkëjetesën e tretë (mes Chirac-ut në Elysee dhe Lionel Jospin si kryeministër) politika e jashtme dhe mbrojtja mbetën prerogativa e kreut të shtetit. Por kjo "domaine réservé" nuk është e detajuar në Kushtetutë. Dhe është qeveria ajo që ka levat e buxhetit të shtetit. Nëse e djathta ekstreme vjen në qeveri dhe vendos të shkurtojë fondet e Francës për BE-në, duke krijuar një casus belli me Brukselin, Macron do të ketë pak ndikim. Po kështu nëse kryeministri i ri dëshiron të reduktojë ndihmën ushtarake për Ukrainën. E kam fjalën për formën. Në praktikë, do të bëhet fjalë për njerëzit dhe marrëdhëniet e pushtetit.

Çfarë ndodh nëse asnjë parti nuk merr shumicën absolute të dielën e ardhshme?

Unë mirëpres vendimin e bllokut qendror dhe të majtë për paktin e rezistencës, ose për tërheqjen e kandidatëve për të penguar fitoren e së djathtës ekstreme. Këto marrëveshje mund të jenë bazë për marrëveshje të gjera pas votimit, në mungesë të shumicës absolute. Në këtë skenar, presidenti do të emëronte një kryeministër si Monti apo Draghi. Fatkeqësisht, nuk do të jetë e lehtë të gesh figura të ngjashme në establishmentin francez, sepse nuk jemi mësuar me drejtues teknikë. Në romanin e tij të fundit, ju

imagjinoni ardhjen e Le Pen në Elysée.

Nuk do ta kisha imagjinuar kurrë rrezikun e një qeverie të ekstremit të djathtë në 2024, me zgjedhjet e afuara në këtë mënyrë nga Macron. Edhe sot nuk dorëzohem: do të ishte një tronditje për Evropën. Dhe qeveria Bardella nuk do të ishte një qeveri Meloni. Rassemblement National më shumë do ta shtynte Francën drejt Hungarisë së Orbanit.

A nuk ju pengoi aleanca e Partisë Socialiste me France Insoumise të Jean-Luc Mélenchon-it, të votoni majtas?

Unë kurrë nuk do të votoj për RN-në, absolutisht kurrë, dhe do të votoj gjithmonë për kandidatin e së majtës, madje edhe për një kandidat të France Insoumise, me përjashtim të disa emrave antisemitë. Është thellësisht e padrejtë të barazohet e djathta ekstreme me shumicën e demokracisë sociale. Dhe mendoj se e majta reformiste do të mund të rifitojë hapësirën e saj në të ardhmen e afërt. Në vitin 1974, isha tridhjetë vjeç, drejtova fushatën e parë presidenciale të Mitterrand. Socialistët kishin 12-13% të votave dhe komunistët 85%. Partia Komuniste ishte një parti e Moskës, shumë larg nesh. Megjithatë, ne ishim të bindur se aleanca ishte e nevojshme dhe ne do të ishim në gjendje të ndryshonim ekuilibrin e pushtetit. Kjo është ajo që ndodhi më pas. Tani mund të ndodhi përsëri. / La Repubblica - Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT
EURO2024 GERMANY



Afati kalimtar fillon sot, përfundon më 1 shtator

PRISHTINË, 1 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar të gjitha klubet se afati kalimtar veror fillon më 2 korrik dhe përfundon më 1 shtator, duke përfshirë të gjitha regjistrimet e

lojtarëve profesionistë, amatorë, ligat e femrave dhe grupmoshat. Regjistrimet e lojtarëve amatorë do të miratohen vetëm nga Lidhjet Rajonale përkatëse. Për çdo

paqartësi lidhur me regjistrimet, ju lutemi të kontaktoni administratorin/en në Lidhjen tuaj rajonale për ndihmë dhe udhëzime të mëtejshme. Po ashtu edhe

faturat për regjistrime duhet të merren në zyrën e Lidhjeve Rajonale të Futbollit. Ndërkaq, transferet ndërkombëtare të lojtarëve duhet të kryhen përmes sistemit TMS.



Portugalia dhe Franca kualifikohen në çerekfinale

“Epoka e re”

FRANKFURT, 1 KORRIK - Portugalia dhe Franca janë dy kombëtarët e radhës që e kanë siguruar kualifikimin në çerekfinale të Kampionatit Evropian “Euro 2024”. Portugalia ka prerë një biletë për në çerekfinalen e Evropianit, pasi mundi me penallti Slloveninë. 120 minutat përfunduan pa gola, mes dramës dhe spektaklit, në stadiumin e Frankfurtit të tejmbushur me tifozë. Në pjesën e parë, “luzitanët” u vendosën në kërkim të golit, por pa mundur dot të jenë konkret para porte. Për t’u theksuar dy raste të Cristiano Ronaldos, i cili shkaktoi drithërima te porta e mbrojtur nga Oblak. Në pjesën e dytë, sllovenët u bënë “mur”, duke mos lejuar

hapësira për kundërshtarit. Më pas, të besuarit e Kek tentuan me kundërsulme. Në kohën e shtesës, e pabesueshme por e vërtetë, Ronaldo gaboi nga pika e bardhë e penalltisë. Portugalia siguroi suksesin vetëm falë ekzekutimit të 11-metërshave, duke bërë kështu që Cr7 me shokë të shkojë në çerekfinale, aty ku do përballlet me Francën. Franca është kualifikuar për në fazën çerekfinale të Evropianit, pasi mori një fitore 1-0 ndaj Belgjikës në Dusseldorf. Sfidani nisi me raste nga të dyja skuadrat, të cilat provuan në portat e njëra-tjetrës, por pa mundur të gjenin rrjetën. Takimi u zhblllokua në minutën e 85’ nga një autogol i Vertonghen, që vendosi fatin e kësaj ndeshje. Franca avancoi për në çerekfinale, aty ku do të sfidojë Portugalinë.



‘The Guardian’: Xhaka është vetëm tri ndeshje larg të jetë kandidatët për ‘Topin e Artë’

LONDËR, 1 KORRIK - Zvicra kaloi Italinë, në raundin e 1/8 të finaleve të Euro 2024, falë një loje bindëse dhe domunuese përballë “Azzurrëve”. Padyshim falë kësaj performance, Xhaka dhe lojtarët zviceran mund të besojnë se mund të shkojnë larg në këtë evropian. Pasi tifozëve zviceranë iu desh të prisnin 31 vjet për fitoren ndaj Italisë në 1/8-at e Evropianit, në rastin e Anglisë pritja është tashmë 43-vjeçare. Në maj të vitit 1981, kombëtarja helvete festoi për herë të fundit suksesin ndaj rivalëve



anglezë, 2-1 në kualifikueset e Botërorit para 40 mijë tifozëve në Jogeli. Zvicra dhe Anglia u takuan për herë të fundit në një ndeshje zyrtare në vitin 2019. Në ndeshjen

për vendin e tretë në Ligën e Kombeve, ata humbën ngushtë pas goditjes së penalltive. Për Granit Xhakën fjalët më të mira s’i kurseu as mediumi “The Guardian”. “Granit Xhaka është vetëm tri ndeshje larg që të jetë një nga kandidatët më serioz për “Topin e Artë”, shkruan mediumi anglez. Xhaka në katër ndeshje të këtij evropiani ka marrë dy herë çmimin si lojtari më i mirë i ndeshjes, gjersa ka qenë si një ‘komandant’ në fushën e lojës për Zvicrën.

FBK-ja shpërblehet nga FIBA Europe

PRISHTINË, 1 KORRIK - Federata e Basketbollit të Kosovës shpërblehet nga FIBA Europe për organizimin e suksesshëm të FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla - Femrat 2024. Kosova për herë të parë ishte nikoqire e FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla - Femrat 2024. Pesë ditë ndeshje me 8 ekipe të Evropës, ku publiku vendas dhe ai i huaj patën rastin të përjetojnë nga afër emocione dhe lojë të bukur në Prishtinë. “FIBA ndau çmimin për organizimin e suksesshëm të Kampionatit për Federatën e



Basketbollit të Kosovës dhe çmimin e pranoi kryetari i Federatës, Arben Fetahu”, thuhet në njoftimin e FBK-së.

Dukagjini konfirmon largimin e 12 futbollistëve


KLINË, 1 KORRIK - Skuadra e Dukagjinit vazhdon me ndryshime për sezonin e ri futbollistik. Nga kjo skuadër të hënën janë larguar 12 futbollistë, që ishin pjesë e klubit përgjatë sezonit të


kaluar dhe më shumë. Largimin e futbollistëve e ka konfirmuar vetë klubi i Dukagjinit, përmes një postimi në rrjetin social “Facebook”. “KF Dukagjini njofton se me marrëveshje të dyanshme ka

ndarë rrugët me këta futbollistë: Kenan Haxhihamza, Ardin Dallku, Blerind Morina, Bujar Shabani, Redon Sylja, Gentril Salihu, Iran Junior, Dren Feka, Osman Mëziu, Amsal Krasniqi, Paulo


Victor dhe Pascal Chidi Bolu. Klubi falënderon të gjithë për kontributin e dhënë gjatë kohës sa ishin pjesë e familjes tonë dhe u dëshiron suksese në vazhdim të karrierës”, thuhet në njoftimin e kësaj skuadre.







REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT


Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 21.05.2024, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor junior për auditim të performancës

Numri i referencës: AJAP/ZKA/05-06/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1018 të datës 01.07.2024.

Prishtinë, 01.07.2024 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore



OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA


Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 21.05.2024. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Junior Revizor za reviziju učinka

Broj referencë: AJAP/ZKA/05-06/24

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 1018 od datuma 01.07.2024.

Priština, 01.07.2024 Departman za upravljanje ljudskim resursima



NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Creative Hub Data Science” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811989039 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Creative Hub Data Science” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811989039 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Creative Hub Data Science” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811989039 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



N.P.L. “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A.
GJAKOVË

Komuna e Gjakovës
Opština Djetovica Gjakova Municipality
N.P.L. “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A.
GJAKOVË
Nr.: 256
Data: 01.07.2024

KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

NUJ: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 1402000001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Regullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve dhe neni 15 pika 14 të Rregullores nr.121 të dt. 04.04.2016 për Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësisë të Stafit Punues, dhe vendimit nr. Prot 255/01.07.2024 të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” SH.A., Gjakovë, shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Biletar

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Grumbullon të hyrat nga transporti privat ndërrurban;
- Grumbullon të hyrat nga transporti privat që kanë udhëtime jasht shtetit të Republikës së Kosovës;
- Dorzon pazarin ditor çdo ditë te arkatari i ndërmarrjes;
- Kontollon hyrjet-daljet te portave;
- Merr informata që kanë të bëjnë me shërbimet e sigurisë dhe të mbrojtjes së objektit dhe hyrje daljeve të auto transportuesve dhe bënë evidentiimin e tyre;
- Kryen dhe punë dhe detyra të tjera të caktuar nga Shefi Stacionit dhe KE.
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit Stacionit.

Kushtet për pjesmarrje: Kualifikimi dhe Aftësitë:

- Përgaditje mesme shkollore;
- 1 (një) vit përvojë pune;
- Të jetë i aftë për punë në grup dhe të jetë bashkëpunues me operatorët e transportit privat;
- shkathësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Diploma mbi shkollimin.
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më te vjetër se 3 muaj;

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.


Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Konkursi është i hapur nga data: 02.07.2024 deri më 16.07.2024.

-Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Gjakovë, më 01.07.2024







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

